



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2441/ 7 prot.

Datë 28 /10/2025

V E N D I M
Nr. 1541/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28 /10/2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekti:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” sh.p.k në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-51987-06-20-2025, me objekt: “Blerje materiale pastrim ambienti, për Drejtorine e Përgjithshme të Mirembajtjes së Objekteve Publike”, me fond limit: 6,162,436.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 09-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike Shkodër.

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të ofertave lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik “Euromega 2010” SHPK, në procedurën e prokurimit.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” sh.p.k me NIPT M11815028I dhe adresë Tiranë, Rruga e Kavajes, Buka SH.A, Nr.8240, Njësia Nr.6.

Autoriteti Kontraktor:	Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike Shkodër dhe adresë: Lagjia Tre Heronjtë, Rruga “Marin Bicikemi” Shkodër.
Subjekte të Interesuara:	Operatori ekonomik “Euromega” SHPK, Nipt K91624505A, dhe adresë: Tiranë, Prezë Fshati Ahemtaq, pranë firmës Ital Kon.
Baza Ligjore:	Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me nenin 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 23-06-2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me nr. REF-51987-06-20-2025, me objekt: “Blerje materiale pastrim ambienti, për Drejtorinë e Përgjithshme të Mirembajtjes së Objekteve Publike”, me fond limit: 6,162,436.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 09-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike Shkodër.

II.2 Në datën 18.07.2025 është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH) si më poshtë:

“ ANBIM” SHPK	3.218.979	lekë	Skualifikuar
“Euromega 2010” SHPK	4 .621. 835	lekë	Kualifikuar
"BORIS 2019" SHPK	5.688.250	lekë	Skualifikuar
“Albania Distribution Chemicals” SHPK	5.961.390	lekë	Skualifikuar

II.3. Në datën 08.09.2025 Autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim Fituesin Paraprak në SPE.

II.4. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor, është depozituar ankesa me numër ankimi A/2025/5790, datë 10.09.2025 dhe me nr.2441/2025 Prot., dhe protokolluar me datë 11.09.2025 e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals”,shpk duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së tij dhe duke kundërshtuar ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik “Euromega 2010” shpk pjesëmarrës në procedurën e prokurimit .

II.5 Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 2441/1 prot., datë 11.09.2025, janë publikuar pretendimet e operatorit ekonomik ankimes në lidhje me arsyet e skualifikimit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals”,shpk .

II.6 Më datë 18.09.2025 , pranë Komisionit të Prokurimit publik, autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike Shkodër, me shkresën me nr. 2441/3 prot., datë

17.09.2025, më lëndë: “Kthim përgjigje”, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” sh.p.k” ku ka vendosur mospranimin e ankesës. Gjithashtu Shkresa e sipërmendur e autoriteti kontraktor ka ardhur edhe nëpërmjet rrugës postare e cila është regjistruar me nr. 2441/4 datë 18.09.2025.

II.7. Nga verifikimet e kryera, rezulton, se janë paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik argumente nga subjekte të interesuara lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik Albania Distribution Chemicals”,shpk, nga operatori ekonomik “EURO MEGA 2010” SHPK sipas parashikimeve të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals”,shpk mbi vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së paraqitur, me arsyet se:

[1-Formulari I oferes nuk eshte plotesuar sakte sipas shtojces nr.1 te DST pasi vlera e ofertes eshte vendosur vetem me numra dhe jo me fjale sic percktohet ne shtojcen perkatese te DST].., Komisioni i prokurimit publik vëren se,

III.1.1 Autoriteti kontraktor ka parashikuar në shtojcën 1, të dokumentave standarte të tenderit “ Formularin e ofertës ekonomike”, si më poshtë:

Shtojca 1.

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit]**, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti), nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontratës;
 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

III.1.2. Operatori ekonomik rezulton se ka ngarkuar ne sistem formularin e ofertes me te dhena si në vijim: Formulari i Ofertës, datë, me 09.07.2025 Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: REF-51987-06-20- 2025, Për: Drejtoria e Përgjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike, Emri i

ofertuesit dhe NIPT-i: Albania Distribution Chemicals, M11815028I...si dhe gjithashtu në gjermën **(e)** ka përcaktuar Cmimin total i ofertës sonë **pa Tvsh është: xx xx xx.**

III.1.3. Në nenin 2 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

III.1.4. Në nenin 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.5. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”

III.1.6. KPP thekson, se një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Me marrjen pjesë në procedurën e prokurimit, operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. KPP gjykon, se zbatimi i parimit të transparencës, barazisë, dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime, ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion të barabartë, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur vlerësohen ato.

III.1.7. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, ka paraqitur Shtojcën 1 me emërtimin “Formulari Ofertës”, me objekt prokurimi është “Blerje materiale pastrim ambienti, për Drejtorinë e Përgjithshme të Mirembajtjes së Objekteve Publike”, të dokumenteve të tenderit të publikuara në SPE.

Gjithashtu, rezulton se, në gërmën “e” të shtojcës 1 “Formulari i Ofertës”, operatori ekonomik ankimues ka deklaruar se: “e) Çmimi total i Ofertës sonë, pa TVSH, është: xx xx xx .

Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, thuhet shprehimisht se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë: “*Devijimi*” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit; “*Rezervimi*” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe “*Mospranimi*” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë”, ndaj ndryshimi i sasive të mallit të ofruar nga ankimuesi nga sasi të kërkuara nga AK është shmangie e ofertuesit nga kërkesat dhe nevojat e autoritetit kontraktor të specifikuara në dokumentet e tenderit. KPP thekson, se një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Me marrjen pjesë në procedurën e prokurimit, operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. KPP gjykon, se zbatimi i parimit të transparencës barazisë, dhe mosdiskriminimit janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime, ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion të barabartë, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur vlerësohen ato. Në rastin konkret Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ankimues, ka cituar vlerën e ofertës së paraqitur nga ana e tij vetëm në formë shifrash xx xx xx dhe nuk është cituar vlera e ofertës edhe në formën e fjalëve. Komisioni gjykon, se nuk jemi në kushtet e mospërputhjes ndërmjet fjalëve dhe shifrave, të parashikuara në nenin 82, pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, 30 i ndryshuar. Gjithashtu nuk jemi para faktit të Nenit 92 i ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku përcaktohet, rasti, se nga ana e autoritetit kontraktor nuk mund të lejohet ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme. Në këto kushte, Komisioni gjykon, oferta e paraqitur nga ankimuesi nuk ka pasaktësi thelbësore, që të dërgojë në rastin e pavlefshmërisë së ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik. Fakti që operatori ekonomik ka paraqitur vlerën e ofertës së tij vetëm në formën e shifrave dhe jo edhe në formën e shprehur edhe nëpërmjet fjaleve, kjo nuk çënon thelbin e ofertës së paraqitur.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik qëndron.

III .2. Lidhur me arsyen e skualifikimit te operatorit ekonomik me pretendimin se: ...2-Lista e cmimeve sipas shtojces nr.2 te DST nuk eshte plotesuar sakte ne njesine matese sipas shtojces te publikuar nga AK pasi ne vendet ku nga AK eshte percaktuar se paketimi duhet te jete me 750 mL,1L,3L,5L , etj ju keni ofertuar me cope duke mos percaktuar sakte sasine e mallit qe ofertoni gje qe do sillte probleme edhe ne realizimin e kontrates, Komisioni i prokurimit publik vë re se .

III.2.1. Në shtojcën 3 “Lista e çmimeve të artikujve” dhe 7, “ Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet autoriteti kontraktor ka parashikuar kriterin si më poshtë:

Shtojca 7.

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Emertimi i produktit	Njesia matese	Cmimi
1	Solucion lares dysHEMEJE (pLLakash)	1 Liter	450
2	Pluhur lares lavatrice per rroba te bardha	Kg	185
3	Pluhur lares lavatrice per rroba me ngjyre	Kg	217
4	Pluhur lares per rroba larje me dore	Kg	172
5	Solucion lares xhamash	750 ml	960
6	Solucion lares enesh leng	500 ml	460
7	Solucion lares enesh leng	1 liter	310
8	Solucion lares enesh leng	3 liter	120
9	Solucion lares enesh xhel	400 gr	340
10	Solucion per pastrim te parketit	1 Liter	235
11	Solucion zbutesh dhe aromatizues rrobash	2 Liter	180
12	Solucion zbutesh dhe aromatizues rrobash	5 Liter	155
13	Solucion lares per mobilje	750 ml	80
14	Shampo antiparazitare (pedikulocid)	500 ml	80
15	Shampo parazitesh, per larje koke	500 ml	75
16	Shampo per larje koke	400 ml	445
17	Shampo per larje koke	500 ml	77
18	Shampo per larje trupi	500 ml	212
19	Shampo per larje trupi	750 ml	55
20	Sapun i lengshem	500 ml	420

21	Sapun i lengshem	1 Liter	215
22	Detergjent i parfumar	5 kg	22
23	Detergjent i parfumar	20 kg	11
24	Detergjent kunder yndyrnave	750 ml	60
25	Detergjent kunder yndyrnave	1 Liter	44
26	Detergjent kunder njollave (sgrasatore)	750 ml	60
27	Detergjent kunder njollave (sgrasatore)	5 Liter	20
28	Sapun rrobash	100 g	144
29	Sapun rrobash	300 g	133
30	Sapun rrobash	500 g	55
31	Sapun tualeti duarsh	75g	114
32	Sapun tualeti duarsh	100g	251
33	Sapun tualeti duarsh	125g	120
34	Detergjent pluhur per makinat larese	Kg	840
35	Acid per pastrim	1 Liter	1400
36	Acid muriatik	1 Liter	200
37	Acid organik pastrues	1 Liter	1400
38	Acid natyror laktik	1 Liter	33
39	Solucion kundra yndyres	750 ml	270
40	Solucion kundra yndyres	1 Liter	155
41	Solucion lares EC dezinfektues	1 Liter	1140
42	Zbardhues rrobash	1 Liter	128
43	Solucion per pastrimin e smercit/kriprave nga hidrosanitaret me mekanizem sprucimi	1 Liter	166
44	Solucion per pastrimin e smercit/kriprave per lavatrice	Kg	45
45	Solucion per zhbllokim lavamani	1 Liter	80
46	Solucion per zhbllokim lavamani	5 Liter	122
47	Solucion per zhbllokim banjo	500 ml	240
48	Spray kunder pluhurit	300 ml	60
49	Aromatizues zyre	300 ml	75
50	Xhel dezinfektant per duart	500 ml	177
51	Alkool etilik 70 %	1 Liter	145
52	Maske kirurgjikale e thjeshte	Cope	400
53	Maske prej pelhure	Cope	239
54	Doreza Latex ose Nitrile	Pako	145
55	Hipoklorit Natriumi NaOCl 10-12%	Liter/Kg	650
56	Hipoklorit Kalciumi, permbajtja e klorit aktiv 30%-40%	Kg	140
	"BLERJE MATERIALE PER PASTRIM"		

	Emertimi i produktit		
60	Fshese merimangash me shklop	Cope	40
61	Fshese pastrimi per ambientet e jashtme (industriale)	Cope	82
62	Fshese me sfungjer dhe gome per pastrimin e xhamave	Cope	80
63	Fshese gome me bisht	Cope	300
64	Kuti mbledhese plehrash (kaci) me fshese	Cope	185
65	Kuti mbledhese plehrash (kaci) me gomine dhe me bisht plastik	Cope	120
66	Shtupe per larje dyshemeje	Cope	600
67	Lecke pastrimi pllakash	Cope	600
68	Furca per lysterje muri me gelqere	Cope	130
69	Furca pastrimi lavamani	Cope	80
70	Furca per pastrimin e EC-se	Cope	60
71	Lecka per larje xhamash (permasa 32 x 32 cm)	Cope	280
72	Kartepiceta buke (100 fije/pako)	Pako	2400
73	Peceta pluhresh te thjeshta (3 fije/pako)	Pako	600
74	Leter kasete banjo	Pako	1800
75	Leter alumini (10m)	Rulon	85
76	Leter guzhine e paketuar (10m)	Rulon	60
77	Leter higjenike e paketuar (min 10 rulon/paketim)	Pako	1300
78	Letra te lagura higjenike per bebe (min 100 fije/pako)	Pako	160
79	Letra te lagura higjenike per te rritur (min 100 fije/pako)	Pako	30
80	Peceta pastrimi mikrofiber (3 fije/pako)	Pako	60
81	Govate plastike per bebe	Cope	40
82	Kosh plastik per hedhjen e mbeturinave (30 liter)	Cope	225
83	Karroce per larje dhe shtrydhje me rrota me mekanizem (10 liter)	Cope	4
84	Kove plastike me shtrydhje (10 liter)	Cope	440
85	Legen plastik (20 liter)	Cope	62
86	Kosha tualeti me pedale (3 Liter)	Cope	120
87	Legen i vogel plastik (7 liter)	Cope	40
88	Qese mbeturinash (35 liter)	Pako	400
89	Sfungjer enesh i thjeshte	Cope	180
90	Sfungjer per pastrim hidrosanitaresh	Cope	125
91	Sfungjer per larjen e trupit	Cope	180
92	Tel enesh	Cope	180
93	Tel i imet enesh	Cope	200
94	Zhblllokues lavamani gome	Cope	50
95	Mbulese tavoline plastike (mushama)	Meter linear	455

Afatet e lëvrimit: 30 dite kalendarike

III.2.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë 6 shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

III.2.3. Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktorë garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktorë nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktorë janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.*

III.2.4 Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktorë përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktorë mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktorë mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktorë mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktorë mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të

përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktorë mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktorë, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktorë përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.2.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar në sistem dokumentacionin “Lista e cmimeve të artikujve ” datë 09.07.2025 nga “Albania Distribution Chemicals” shpk . Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, sikurse përmendëm edhe më sipër, nga ana e operatorit ekonomik ankimues është ngarkuar në SPE dokumentacioni Lista e cmimeve të artikujve datë 09.07.2025 me artikujt e kërkuar nga autoriteti kontraktor për objektin e prokurimit “Blerje materiale pastrim ambienti”. Konkretisht autoriteti kontraktor për artikujt si në vijim e ndër të tjerë, ka kërkuar: **Solucion lares dyshemeje (pllakash), 1 Liter; Solucion lares xhamash, 750 ml; Solucion lares enesh leng, 500 ml; Solucion per pastrim te parketit, 1 Liter; Solucion zbutes dhe aromatizues rrobash, 2 Liter; Solucion lares per mobilje 750 ml,** Komisioni i prokurimit publik, vlerëson se pas verifikimeve të dokumentacionit të depozituar në SPE nga operatori ekonomik ankimues rezulton se për artikujt :

*Solucion lares dyshemeje (pllakash), 1 Liter; Solucion lares xhamash, 750 ml; Solucion lares enesh leng, 500 ml; Solucion per pastrim te parketit, 1 Liter; Solucion zbutes dhe aromatizues rrobash, 2 Liter; Solucion lares per mobilje 750 ml, **ka ofertuar me njësi matëse “Copë”**, e rrjedhimisht jo në përputhshmëri kjo me kërkesat e parashikuara në shtojcën nr. 7 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit”, pjesë e dokumentave standarte të tenderit parashikuar nga autoriteti kontraktor.*

Komisioni në vlerësim të ligjit për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Vlerësimi i ofertave referuar kriterëve të tjera të kualifikimit, të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, jo vetëm që është në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, por cënon gjithashtu parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 3 i lex specialis, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve. Për sa më sipër referuar dokumentacionit të paraqitur në SPE “Lista e cmimeve të artikujve, nga operatori ankimues, rezulton se nuk ka ofertuar në përputhshmëri me shtojcën nr. 7 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit”, ku njësi matëse e përcaktuar sipas llojit të artikullit të kërkuar në DST, duhet të jetë e saktë dhe në përputhshmëri me atë cfarë është e përcaktuar nga autoriteti kontraktor, e konkretisht njësi matëse të jetë sipas zërit të artikullit e cila rrjedhimisht ndikonë dhe ka efekt në sasinë e mallit që operatori ekonomik do të ofertojë.

Sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals”, shpk mbi vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Euromega 2010” shpk, me arsyet se, ...[Në njërin prej kriterve AK ka kërkuar: 2.3.6 Për Klorin lëng (Hipoklorit Natriumi) duhet të paraqesë Raport Analize nga ISHP (Instituti i Shendetit Publik) ose institucione të tjera të akredituara .

Ndersa ne shtojcen 1 AK ka kërkuar artikullin 29 Hipoklorit Natriumi 10-12 %. Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur analizen e Institutit te Shendet Publik dhe madje as me parametrat e kërkuar nga AK pra Hipoklorit Natriumi 10-12%. Per tju dhene shembull po ju vendosim ne dispozicion analizen tone te kryer prane Institutit te Shendetit Publik. Per kete aresy kerkojme qe OE Euro Mega 2010 te skualifikohet per mosplotesimin e kriterit 2.3.6.]...Komisioni i prokurimit publik vëren se,

III.3.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Albanian Distribution Chemicals” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Euromega 2010 ” shpk , nga procedura e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se, për sa kohë statusi i tij do të mbetet i skualifikuar, referuar arsyetimit në pikën III.2.5 të këtij vendimi, gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Albanian Distribution Chemicals” SHPK, nuk do të ndryshojë duke mbetur i skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke mospërmbushur interesin e ankimuesit.

Për sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk do të merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” sh.p.k për procedurën e prokurimit publik “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-51987-06-20-2025, me objekt: “Blerje materiale pastrim ambienti, për Drejtorinë e Përgjithshme të Mirëmbajtjes së Objekteve Publike”, me fond limit: 6,162,436.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 09-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike Shkodër.
 2. Autoriteti kontraktor të rivlersojë ofertën e operatorit ekonomik sipas konstatimeve të mësipërme të vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse, për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Albanian Distribution Chemicals” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Florent Zguro

